



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E GAZETAREVE TË TELEVISIONIT KLAN KOSOVA NË ZGJEDHJET**  
**PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS**  
**30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 27.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi gështjen me:

**OBJEKT:** Miratimi i gazetarëve të paraqitur nga televizioni Klan Kosova për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

**V Ë R E N**

Televizioni Klan Kosova ka paraqitur kërkesën e saj me nr. 12464 Prot të datës 27.06.2019, bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 4 (katër) gazetarëve.

Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 e Kodit Zgjedhor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KQZ vëren se ai është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 4 të Udhëzimit nr.13 datë 22.04.2009 të KQZ "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare



shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave".

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

### **V E N D O S I :**

1. Të miratojë kërkesën e televizionit Klan Kosova, për akreditimin e 4 (katër) gazetarëve, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.4, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>

